|----|--|---------|--------------------|-------------------|------------------|--------------------|--------------------|--------------------|------------|
| 11 | FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME | 2112001 | | | | 0 | | 0 | 0.0 |
| 12 | SPORT DHE ARGËTIM | 2112001 | 4,098,795 | 699,766 | 71,540 | 4,870,101 | 7,726,562 | 12,596,663 | 2.8 |
| 13 | TRASHËGIMIA KULTURORE , EVENTET ARTISTIKE, DHE KULTURORE | 2112001 | 15,901,749 | 2,684,812 | 470,120 | 19,056,681 | 3,924,480 | 22,981,161 | 5.2 |
| 14 | ARSIMI BAZË | 2112001 | 47,316,278 | 7,982,164 | 655,445 | 55,953,887 | 9,260,000 | 65,213,887 | 14.7 |
| 15 | ARSIMI I MESËM | 2112001 | 4,277,338 | 724,875 | 150,805 | 5,153,018 | 3,516,727 | 8,669,745 | 1.9 |
| 16 | PËRKUJDESË SOCIAL | 2112001 | 3,049,876 | 526,687 | | 3,576,563 | 5,976,000 | 9,552,563 | 2.1 |
| 17 | STREHIMI SOCIAL | 2112001 | | | | 0 | 7,353,623 | 7,353,623 | 1.7 |
| | totali | | 250,357,253 | 42,702,738 | 4,957,501 | 298,017,492 | 146,938,820 | 444,956,312 | 100 |

III.3 Shpenzime për Personelin

Totali i shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore dhe fond i veçantë) për të gjitha funksionet Bashkisë Patos për vitin 2024 është parashikuar në shumën **293,059,991** lekë ose 49 % të shpenzimeve totale.

Shpenzimet e personelit dhe përqindja sipas programeve kundrejt totalit të shpenzimeve të personelit të Bashkisë Patos paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 12

| Nr | Programi | Njesia Shpenzuese | Shpenz. Paga | Shpenz. Sigurime | Shpenz. Personeli | Raporti në % |
|----|--|-------------------|--------------|------------------|-------------------|--------------|
| 1 | PLANIFIKIMI, MENAXHIMI, ADMINISTRIMI | 2112001 | 55,404,241 | 9,780,542 | 65,184,783 | 22.2 |
| 2 | MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE | 2112001 | 11,721,168 | 1,984,755 | 13,705,923 | 4.7 |
| 3 | SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, SIGURIA USHQIMORE, DHE MBROJTJA E KONSUMATOREVE | 2112001 | 3,122,776 | 533,098 | 3,655,874 | 1.2 |
| 4 | MENAXHIMI I INFRASTRUKTURES SE UJITJE KULLIMIT | 2112001 | 3,869,015 | 666,833 | 4,535,848 | 1.5 |

BUXHETI 2024

| | | | | | | |
|----|--|----------------|--------------------|-------------------|--------------------|------------|
| 5 | ADMINISTRIM I PYJEVE DHE KULLOTAVE | 2112001 | 2,924,227 | 492,570 | 3,416,797 | 1.2 |
| 6 | RRJETI RRUGOR RURAL (INFRASTRUKTURES) BASHKIA | 2112001 | 14,079,720 | 2,498,081 | 16,577,802 | 5.7 |
| 7 | RRJETI RRUGOR RURAL Njesia shpenz. A.SH.P | 2112009 | 3,000,000 | 501,000 | 3,501,000 | 1.2 |
| 8 | MENAXHIMI I MBETJEVE MBROJTJA E MJEDISIT | 2112001 | 773,570 | 130,865 | 904,435 | 0.3 |
| 9 | MENAXHIMI I MBETJEVE Njesia shpenz. A.SH.P | 2112009 | 25,306,500 | 4,226,186 | 29,532,685 | 10.1 |
| 10 | SHERBIME PUBLIKE VENDORE Njesia shpenz. A.SH.P | 2112009 | 55,512,000 | 9,270,504 | 64,782,504 | 22.1 |
| 11 | FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME | 2112001 | | | | 0.0 |
| 12 | SPORT DHE ARGËTIM | 2112001 | 4,098,795 | 699,766 | 4,798,561 | 1.6 |
| 13 | TRASHËGIMIA KULTURORE , EVENTET ARTISTIKE, DHE KULTURORE | 2112001 | 15,901,749 | 2,684,812 | 18,586,561 | 6.3 |
| 14 | ARSIMI BAZË | 2112001 | 47,316,278 | 7,982,164 | 55,298,442 | 18.9 |
| 15 | ARSIMI I MESËM | 2112001 | 4,277,338 | 724,875 | 5,002,213 | 1.7 |
| 16 | PËRKUJDESI SOCIAL | 2112001 | 3,049,876 | 526,687 | 3,576,563 | 1.2 |
| 17 | STREHIMI SOCIAL | 2112001 | | | | 0.0 |
| | totali | | 250,357,253 | 42,702,738 | 293,059,991 | 100 |

III.4 Shpenzimet Operative

Shpenzimet operative për vitin 2024 paraqiten në shumën **146,938,820** lekë, të cilat krahasuar me vitin 2023 kanë qenë në shumën 134,438,000 **lekë**, kanë një ulje 0.22%. Këto shpenzime përbëjnë 33 % të totalit të shpenzimeve korrente, dhe 24.51% të totalit të buxhetit për vitin 2024. Në thelb të planifikimit të shpenzimeve operative vazhdon të jetë racionalizimi i shpenzimeve administrative, duke vënë theksin në funksionet prioritare si dhe në qëllimin e përdorimit të tyre ku qartësisht vërehet se këto shpenzime shkojnë për realizimin e funksioneve kryesore të Bashkisë Patos.

III.5 Fondi rezervë dhe kontigjenca III

Në buxhetin e vitit 2024, Fondi rezervë dhe ai i Kontigjencës, nga burimet e veta të llogaritur sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, arrijnë së bashku në shumën 6.132,000 lekë **Fondi rezervë dhe i kontigjencës përbëjnë 1 % të totalit të buxhetit.**

Fondi Rezervë do të përdoret:

Për financimin e shpenzimeve që nuk mund të parashikohen gjatë hartimit të buxhetit, me vendime të Këshillit Bashkiak. Për vitin 2024 kemi parashikuar 4,258,486 lekë.

Fondi i Kontigjencës do të përdoret:

Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese, në rast se do të jetë e nevojshme gjithmonë me miratimin e Këshillit Bashkiak. 3,066,000 lekë.

Totali i shpenzimeve të Bashkisë Patos (korente dhe kapitale) në lekë, në nivel programi mbështetur në të ardhurat e veta paraqitet në tabelë e mëposhtëme :

Tabela Nr.13:

| Nr | Programi | Njesia Shpenzuese | Total 2023 | Total 2024 | Pesha në % per program 2023 | Pesha në % per program 2024 |
|----|--|-------------------|------------|-------------|-----------------------------|-----------------------------|
| 1 | PLANIFIKIMI, MENAXHIMI, ADMINISTRIMI | 2112001 | 96,662,000 | 112,010,640 | 17.8 | 18.7 |
| 2 | MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE | 2112001 | 22,822,000 | 22,431,993 | 4.2 | 3.7 |
| 3 | SHËRBIMET E POLICISË VENDORE | 2112001 | 4,076,000 | 0 | 0.7 | 0.0 |
| 3 | SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, SIGURIA USHQIMORE, DHE MBROJTJA E KONSUMATOREVE | 2112001 | 9,750,000 | 9,520,410 | 1.8 | 1.6 |
| 4 | MENAXHIMI I INFRASTRUKTURES SE UJITJE KULLIMIT | 2112001 | 16,088,000 | 17,002,572 | 3.0 | 2.8 |
| 5 | ADMINISTRIM I PYJEVE DHE KULLOTAVE | 2112001 | 3,846,000 | 3,468,297 | 0.7 | 0.6 |
| 6 | RRJETI RRUGOR RURAL (INFRASTRUKTURES) BASHKIA | 2112001 | 83,956,000 | 117,852,854 | 15.4 | 19.7 |

BUXHETI 2024

| | | | | | | |
|----|--|----------------|--------------------|--------------------|------------|------------|
| 7 | RRJETI RRUGOR RURAL Njesia shpenz. A.SH.P | 2112009 | 2,789,000 | 3,697,102 | 0.5 | 0.6 |
| 8 | MENAXHIMI I MBETJEVE MBROJTJA E MJEDISIT | 2112001 | 1,219,000 | 1,378,121 | 0.2 | 0.2 |
| 9 | MENAXHIMI I MBETJEVE Njesia shpenz. A.SH.P | 2112009 | 41,167,000 | 52,778,140 | 7.6 | 8.8 |
| 10 | SHERBIME PUBLIKE VENDORE Njesia shpenz. A.SH.P | 2112009 | 123,318,000 | 130,344,629 | 22.7 | 21.7 |
| 11 | FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME | 2112001 | 454,000 | 400,000 | 0.1 | 0.07 |
| 11 | SHËRBIMI I KUJDESIT PARËSOR | 2112001 | 1,209,000 | 0 | 0.22 | 0.00 |
| 12 | SPORT DHE ARGËTIM | 2112001 | 9,172,000 | 13,096,663 | 1.7 | 2.2 |
| 13 | TRASHËGIMIA KULTURORE , EVENTET ARTISTIKE, DHE KULTURORE | 2112001 | 27,487,000 | 23,991,161 | 5.1 | 4.0 |
| 14 | ARSIMI BAZË | 2112001 | 76,619,000 | 65,969,487 | 14.1 | 11.0 |
| 15 | ARSIMI I MESËM | 2112001 | 7,293,000 | 8,669,745 | 1.3 | 1.4 |
| 16 | PËRKUJDESI SOCIAL | 2112001 | 9,710,000 | 9,552,563 | 1.8 | 1.6 |
| 17 | STREHIMI SOCIAL | 2112001 | 6,100,000 | 7,353,623 | 1.1 | 1.2 |
| | totali | | 543,737,000 | 599,518,000 | 100 | 100 |

KAPITULLI IV
PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË QYTETIT

PROGRAMET BUXHETORE PËR VITIN 2024.

I. PROGRAMI PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|--------------------------------------|--|
| Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit; | | |
| Kodi i programit | Emri i Programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 01110 | Planifikim, menaxhim dhe administrim | <ul style="list-style-type: none">• Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;• Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjetesh, zyrave të printimit dhe IT etj;• Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë;• Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore;• Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit. <hr/> <ul style="list-style-type: none">• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj;• Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit;• Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, |

| | | |
|--|--|--|
| | | dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale. |
| | | • Administrimi i fondeve të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore. |
| | | • Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore; |
| | | • Amortizimi i huave të marra etj. |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Qeverisje vendore e përgjegjshme dhe administrata e saj transparente*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore për vitin 2024,*
- *Përdorimi sa më eficient,efektivitet dhe ekonomi i burimeve financiare të Bashkisë,*
- *Promovimi i Bashkisë për qeverisje të hapur dhe transparente ,dokumenta te publikuara,*
- *Projekte te zhvillimit urban.*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Qeverisje vendore e përgjegjshme dhe administrata e saj transparente*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore për vitin 2024,*
- *Përdorimi sa më eficient,efektivitet dhe ekonomi i burimeve financiare të Bashkisë,*
- *Promovimi i Bashkisë për qeverisje të hapur dhe transparente ,dokumenta te publikuara,*
- *Projekte te zhvillimit urban.*

Produkti

- *Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim*
- *Akte te miratuara nga Këshilli Bashkiak*
- *Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funkionimi i Aparatit të Bashkisë*
- *Përmbushja e Detyrimeve Gjyqësore*

- *Nëpunës të trajnuar*
- *Transparenca publike*
- *Projekte të zhvillimit urban të hartuara dhe monitoruara*
- *Patrullim për sigurinë publike*

Përshkrimi i Produktit:

- *73 Shërbime administrative që ofrohen për qytetarët nga bashkia.*
- *100 Shërbime të ofruara nga Këshilli Bashkiak dhe stafi i tij kundrej administratës dhe komunitetit.*
- *Funksionimi dhe mirembajtja e Infrastruktues fizike te bashkise përmes sigurimit të shpenzimeve korente apo kapitale për ujë, energji elektrike, internet, telefon, mirëmbajtje, kancelari, karburant dhe mirëmbajtje për mjetet e transportit, pajisje apo furnitura të tjera IT, etj.*
- *Ndjekja e çështjeve gjyqësore dhe shlyerja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.*
- *Zhvillimi i burimeve njerëzore përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë NJVQV apo palë të treta (p.sh. ASPA, projekte të ndryshme, etj.)*
- *Shërbime dhe kostot përkatëse të printimit (ftesa, broshura, m baner, city light, kartolina, albume), prodhim spoti promovues, mbështetje për hostimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ëbsite, promovimi i aktiviteteve në rrjetet sociale, etj.*
- *Hartimi i projekteve të ndryshme nga drejtoria e urbanistikës dhe planifikimit urban; leje per zhvillimin e zonave/njësave të komunitetit (të reja ose rehabilituara); etj.*
- *Të gjitha aktivitetet e Policisë Bashkiake në lidhje me inspektimet per parandalimin e kundravajtjeve administrative (shpenzime karburant, automjete, uniforma); Kostot e personelit të policisë bashkiake (paga dhe sigurime), etj.*

- **Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore**

Bashkia Patos është pjesë e Qarkut Fier dhe ka një sipërfaqe prej 82.5 km², me qendër qytetin e Patosit. Ajo kufizohet në veri dhe në lindje nga bashkia e Roskovecit, në jug me bashkinë e Mallakastrës dhe në perëndim me bashkinë e Fierit. Kjo bashki përbëhet nga dy njësi administrative, të cilat janë: Zharrëza dhe Ruzhdia. Bashkia e Patosit, në bazë të statistikave të vitit 2021 sipas Censurit regjistronte 22.959 banorë dhe densitet prej 278.3 b/km², ndërsa sipas Regjistrisë të Gjendjes Civile në vitin 2021 rezultoi 42,015 banorë.

Aktualisht Bashkia Patos ka perfunduar dhe është gati për zbatimin Planit të Përgjithshëm Vendor i financuar nga Qeveria Qendrore .

Ky Plan reflekton investimet që do të ndërmerren për 15 vitet e ardhshme, duke u ndarë në 5 faza 3 vjeçare, kjo ndarje ka si qëllim që të lidhë projektet e PPV me fazat e planeve buxhetore afatmesëm.

- ❖ **Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë.**

Duke pasur parasysh situatën e qeverisjes vendore është përgatitur një listë të investimeve që kanë më shumë prioritet dhe janë më shumë të nevojshme për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen urbane të qytetit. Këto projekte do të japin zgjidhje të integruar të projekteve të largimit të ujërave të ndotura, kanalizimeve dhe rehabilitimit/ndërtimit të akseve të infrastrukturës.

- **Informacion financiar kryesor**

Bashkia Patos sipas programeve të miratuara nga IFP-ja ka shpërndarë tavane buxhetore në 15 programe. Programet kanë të përfshirë funksione dhe aktivitete sipas natyrës dhe klasifikimit ekonomik. Shpenzimet korente dhe kapitale për programin për vitet 2023 dhe 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme.

| Shpenzimet | Plani 2023 | Plani 2023 |
|---------------------------|-------------------|--------------------|
| Shpenzime Korente | 96,161,785 | 104,378,640 |
| Shpenzime Kapitale | 500,000 | 1,500,000 |
| TOTALI | 96,661,785 | 105,878,640 |

- **Shpenzimet operative për vitin 2024:**

Këto shpenzime paraqiten me ulje në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023. Këto shpenzime përfshijnë:

- Aparatit të Bashkisë Patos, me drejtorite përbërëse të saj.

BUXHETI 2024

- Aparati i Njesisë Administrative Zharrëz
- Aparati i Njesisë Administrative Rruzhdiqe
- Inspektoriatit të Ndërtimit,

Shpërndarja e shpenzimeve operative sipas klasifikimit ekonomik:

- Materiale zyre dhe të përgjithshme
- Materiale e shërbime speciale
- Shërbime nga të tretë
- Shpenzime transporti
- Shpenzime udhëtimi
- Mirëmbajtje të zakonshme
- Shpenzime qiramarrje
- Shpenzime të tjera operative

Totali i këtyre shpenzimeve administrative paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| | Shpenzime Operative | 37,626,750 |
|-----------|---|-------------------|
| 1a | Materiale zyre dhe të përgjithshme | 650,000 |
| 1 | Kancelari | 350,000 |
| 2 | Materiale të ndryshme pastrimi | 300,000 |
| 1b | Materiale e shërbime speciale | 400,000 |
| 1 | Shtypshkrime | 400,000 |
| 1c | Shërbime nga të tretë | 7,600,000 |
| 1 | Energji Elektrike +kontrata të reja | 2,450,000 |
| 2 | Internet | 400,000 |
| 3 | Shpenz/uji | 2,500,000 |
| 4 | Njoftime në media | 200,000 |
| 5 | Shërbime postare | 200,000 |
| 6 | Sistemi Regjistrimit Elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve | 100,000 |
| 7 | Programi i Tarifave Vendore | 1,500,000 |
| 8 | Shpenz Trajnimi për Administratën | 150,000 |
| 9 | Shpenz për Komision Vlerësimi në Administratë | 100,000 |
| 1d | Shpenzime transporti | 3,970,000 |
| 1 | Karburant dhe vaj | 3,000,000 |

BUXHETI 2024

| | | |
|-----------|--|-------------------|
| 2 | Pjese kembimi , goma dhe bateri | 300,000 |
| 3 | Siguracione dhe taksa | 120,000 |
| 4 | Shpenzime te tjera transporti | 550,000 |
| 1e | Shpenzime udhëtimi | 600,000 |
| 1 | Udhëtim jashtë vendit , Dieta. | 300,000 |
| 2 | Udhëtim brenda vendit , Dieta. | 300,000 |
| 1f | Mirëmbajtje te zakonshme | 600,000 |
| 1 | Mirembajtje,sherbime per pajisje informatike | |
| 2 | Mirembajtje per Programe softëarike | 500,000 |
| 3 | Mirembajtje te zakonshme te objekteve administrative | 100,000 |
| 1g | Shpenzime qiramarrje | 2,130,000 |
| 1 | Qeramarje për printime, mirëmbajtje e pajisjeve informatike, bojë dhe letër format. | 2,130,000 |
| 1e | Shpenzime te tjera operative | 21,676,750 |
| 1 | Hipotekime | 200,000 |
| 2 | Sherbime kadastrale per pronat e Bashkise | 100,000 |
| 3 | Shpenz.detyrime gjyqesore | 1,440,000 |
| 4 | Shpenz.per pjesemarrje ne procese gjyqesore | 260,000 |
| 5 | Shpz.per zbatimin e vendimit nr.265 dt 12.02.2020 te vendimit gjyqesor Per Bankersin | 12,532,510 |
| 6 | Kontribut I Bashkise per Qarkun | 500,000 |
| 7 | Shperblim per Keshillin dhe Kryepleqte e Fshatrave | 5,000,000 |
| 8 | Buxheti per Aktivitetet e Këshillit | 300,000 |
| 9 | Kontribut per Shoqaten e Bashkive | 300,000 |
| 10 | Vegla pune | 500,000 |
| 11 | Shpenzime per zbatimin e planit per integritetin dhe antikorupsionin | 306,000 |
| 12 | Shpenzime te ndryshme per projekte per administraten, Bashkinë Patos. | 238,240 |

➤ **Shpenzimet kapitale për vitin 2024:**

Në buxhetin e vitit 2024 kemi paraqitur me kërkesat buxhetore PBA 2024-2026 nevojat për paisje zyre dhe informatike, me vlerën 1,500 000 lekë duke qenë se është bërë rikonstruksioni i njësisë Administrative Zharrëz dhe është parashikuar rikonstruksioni i njësisë Administrative Ruzhdie del si domosdoshmeri për mobilim dhe përshtatja me sistemet e reja të teknologjisë së informatike të punës:

Ndërhyrjet dhe problematikat

| | |
|---|--|
| <p><i>1.Paisje zyre dhe pajisje informatike për një infrastrukturë sa më bashkëkohore për administratën.</i></p> | <p>Projekti parashikon prodhimin e mobiljeve per zyrat e Njësisë Administrative dhe sipas sektoreve specifike që kanë nevojë duke qënë rinovimi i pajisjeve informative është domosdoshmëri për tju përshtatur proceseve të reja teknologjike të punës. Punimi i mobiljeve konsiston ne përdorimin e materialeve të qëndrueshme dhe në mënyrë të tillë që të sigurojnë komoditet dhe produktivitet më të lartë në punën e punonjësve. Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës publike. Përfituesit do të jenë specialiste, pergjegjes e drejtora te drejtorive perkatese dhe njësisë Administrative. Perveç kesaj, përfitues janë edhe qytetaret e Bashkisë Patos të cilet do të marrin një shërbim më cilesor. Pajisjet informatike synojnë përshtatjen me sistemet e reja të informaçonit me të cilat punohet në punën e përditshme dhe të cilat kërkojnë pajisje të reja që të përdoren dhe në këtë mënyrë të sigurojnë komoditet dhe produktivitet më të lartë në punën e punonjësve</p> <p>Vlera e zbatimit të projektit: 1,500,000 leke Kohëzgjatja e projektit: 3 muaj , Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit.</p> |
|---|--|

II. MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|---|---|
| Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përbalimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor. | | |
| Kodi i programit | Emri i Programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 03280 | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | <ul style="list-style-type: none">• Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;• Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;• Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;• Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj. |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit, permytjeve dhe fatkeqësive natyrore dhe ndërhyrjeve për shpëtim*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Përmirësimi i shërbimeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit, permytjeve dhe fatkeqësive natyrore dhe ndërhyrjeve për shpëtim*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Përmirësimi i shërbimeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit*

Produkti

- *Shërbime të mbrojtjes civile*
- *Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit*
- *Punonjës zjarrfikës të trajnuar*

- Familje të dëmshpërblyera për dëme nga fatkeqësitë natyrore
- Familje të dëmshpërblyera për dëme nga zjarri

Përshkrimi i Produkteve:

- Aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e mbrojtjes civile.
 - Krijimi i gadishmërisë së duhur njerëzore, mjete dhe materiale për t'ju përgjigjur në kohë rasteve të zjarrit dhe shpëtimit në objekte banimi, pyje dhe kullota, aksidente në rrugë, etj, aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me marrjen e masave parandaluese të zjarrit apo aksidenteve, përfshirë mjete apo materiale të nevojshme si dhe fushata të ndryshme sensibilizuese.
 - Zhvillimi i stafit në lidhje me proceset e trajtimit të rasteve të zjarrit dhe shpëtimit përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë njësia apo palë të treta (p.sh. MB, projekte të ndryshme, etj.)
 - Shpenzimet e parashikuara për dëmshpërblimin e familjeve të cilat preken nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore.
 - Shpenzimet nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore për shpërblimin e familjeve të dëmtuara nga zjarri sipas legjislacionit për mbrojtjen civile.
- Vlera për realizimin e këtij funksioni është **22,431,993** lekë ,nga të cilat përballohen shpenzimet për personelin në vlerën **14,043,507** lekë, në vlerën **4,130,000** lekë shpenzime operative dhe Fond për Mbrojtjen Civile në vlerën **4,258,486** lekë.

Shpenzimet korente dhe kapitale 2023 dhe plani për vitin 2024.

| Shpenzimet | Plani 2023 | Plani 2024 |
|---|-------------------|-------------------|
| Shpenzime Korente | 19,822,000 | 18,173,507 |
| Fond Emergjence Për Mbrojtjen Civile | 3,000,000 | 4,258,486 |
| Shpenzime Kapitale | 0,000 | 0,000 |
| Total | 22,822,000 | 22,431,993 |

Shpenzimet operative për vitin 2024

Shpenzimet operative për këtë funksion paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Nr | Shpenzime Operative | Viti 2024 | Raporti në % |
|----|------------------------------------|------------------|--------------|
| | TOTAL | 4,130,000 | 100% |
| 1a | Materiale zyre dhe të përgjithshme | 50,000 | 1% |
| 1b | Materiale e shërbime speciale | 786,000 | 19% |
| 1c | Shërbime nga të tretë | 800,000 | 19% |
| 1d | Shpenzime transporti | 2,394,000 | 58% |
| 1f | Shpenzime të tjera operative | 100,000 | 2% |

- Shpenzime për investime nuk janë planifikuar për vitin 2024.

III.SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E KONSUMATORËVE.

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|---|--|
| Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve. | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 04220 | Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve | <ul style="list-style-type: none"> • Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave; • Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore; • Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve; • Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blektorinë; • Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; |

| | | |
|--|--|--|
| | | <p>mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë;</p> <ul style="list-style-type: none">• Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural;• Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit;• Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës. |
|--|--|--|

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj, krijimi projekteve në mbështetje të fermerëve si dhe fuqizimi i përdorimit të qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe kategorive të resurseve të tjera.*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Mbështetja e rritjes së prodhimit bujqësor dhe blektoral*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj, krijimi projekteve në mbështetje të fermerëve si dhe fuqizimi i përdorimit të qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe kategorive të resurseve të tjera.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Mbështetja e rritjes së prodhimit bujqësor dhe blektoral*

Produkti

- *Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor.*
- *Grante për fermerët*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Aktivitetet dhe kostot përkatëse të lidhura shërbimin e këshillimit dhe ekstensionit bujqësor.*
- *Shpenzimet për grantet e dhëna fermerëve për zhvillimin e kulturave apo projekteve të ndryshme.*

BUXHETI 2024

Vlera për realizimin e këtij funksioni është 9,520,410 lekë ,nga të cilat përballohen shpenzimet për personelin në vlerën 3,717,194 lekë dhe 5,803,216 lekë shpenzime operative .

Shpenzimet korente dhe kapitale 2023 dhe plani për vitin 2024.

| | Plani 2023 | Plani 2024 |
|---------------------------|------------------|------------------|
| <i>Shpenzime Korente</i> | 9,750,089 | 9,520,410 |
| <i>Shpenzime Kapitale</i> | 0 | 0 |
| Total | 9,750,089 | 9,520,410 |

➤ Shpenzimet operative për vitin 2024:

Shërbimi i bujqësisë, blektorisë realizohet nga Drejtoria e Zhvillimit Buqësisë dhe Blegtorisë, Bashkia Patos në bashkëpunim me dy Njësitë Administrative Zharrëz dhe Rruzhdiqe.

Shpenzimet operative kanë të bëjnë me :

- Ndërhyrjet në hapjen e rrugëve të parcelave të tokave bujqësore dhe sistemimin e tyre.
- Mbështetjen financiare për fermerët e territorit të bashkisë Patos që ushtrojnë aktivitet me orientim bujqësor-blegtoral
- Krijimin e Grupeve Vendore të Veprimit
- Mostrimin e tokës bujqësore për përmirësimin e vlerave të treguesve të parcelave të tokave bujqësore.

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet operative:

| Nr | Shpenzime Operative | Viti 2024 | Raporti në % |
|-----------|---|------------------|--------------|
| | TOTAL | 5,803,216 | 100% |
| 1a | Shpenzime transporti | 803,216 | 14% |
| 1b | Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme | 1,800,000 | 31% |
| 1c | Shpenzime të tjera operative | 3,200,000 | 55% |

- Shpenzime për investime nuk janë planifikuar për vitin 2024.

IV. MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT.

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|-----------------------------------|---|--|
| Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit. | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 04240 | Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit | <ul style="list-style-type: none">• Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla;• Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësive të vetëqeverisjes vendore. |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Rritja e sipërfaqes së mbuluar me ujitje dhe kullim*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Rritja e sipërfaqes së mbuluar me ujitje dhe kullim*

Produkti

- *Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujitëse dhe kanale kulluese*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Mirëmbajtja rutinë e 15 Km lineare kanale ujitës dhe kanale kulluese nëpërmjet pastrimit, sistemeve, mirëmbajtjeve, meremetimeve apo zëvendësimit të torbinove, etj.*

Vlera për realizimin e këtij funksioni është 17,002,572 lekë ,nga të cilat përballohen shpenzimet për personelin në vlerën 4,587,348 lekë , shpenzime operative në vlerën 7,474,224 lekë, shpenzimet kapitale në vlerën 4,941,000 lekë . Ky program mbulohet në vlerën 16,631,000 lekë nga transfertat specifike dhe 371,572 lekë nga të ardhurat tona.

Shpenzimet korente dhe kapitale 2023 dhe plani për vitin 2024.

| | Plani 2023 | Plani 2024 |
|---------------------------|-------------------|-------------------|
| <i>Shpenzime Korente</i> | 11,147,000 | 12,061,572 |
| <i>Shpenzime Kapitale</i> | 4,941,000 | 4,941,000 |
| Totali | 16,088,000 | 17,002,572 |

➤ **Shpenzimet operative për vitin 2024:**

Shërbimi i ujitje kullimit realizohet nga Drejtoria e Zhvillimit Buqësisë dhe Blegtorisë, Bashkia Patos në bashkëpunim me dy Njësitë Administrative Zharrëz dhe Rruzhdiqe.

Shpenzimet operative kanë të bëjnë me :

- Rehabilitimin e sistemit ujitës dhe kullues në Njësinë Administrative Zharrëz, Njësinë Administrative Patos .
- Shërbimet vjetore të mjeteve, furnizim me karburant të mjeteve të punës.
- Për blerjen e tubove beton/arme të dimensioneve Ø 40- Ø100 si dhe materialeve të ndërtimit të parapeteve Mostrimin e tokës bujqësore për përmirësimin e vlerave të treguesve të parcelave të tokave bujqësore.
- Për materiale mirëmbajtjeje të port-barazheve të sistemit ujitës.
- Për mirëmbajtjen e skemës së elektropompës së ujit.

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet operative:

| Nr | Shpenzime Operative | Viti 2024 | Raporti në % |
|-----------|---------------------------------|------------------|--------------|
| | TOTAL | 7,474,224 | 100% |
| 1a | Shpenzime transporti | 6,224,224 | 83% |
| 1b | Mirembajtje te zakonshme | 1,250,000 | 17% |

➤ **Shpenzimet kapitale për vitin 2024:**

Ndërhyrjet dhe problematikat

| | |
|--|---|
| <i>1. Projekte per ujitje kullimin (bashkefinancim)</i> | Projekti konsiston përmirësimin e rrjetit ujitës, ndërtimin e skemave të reja me projekte (bashkëfinancime) . Vlera e zbatimit të projektit: 4,100,000 leke Kohëzgjatja e projektit: 6 muaj , Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit. |
|--|---|

V. ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE.

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|-------------------------------------|---|
| Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore; | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 04260 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave | <ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore; • Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore; • Administrim i fondit pyjor dhe kullor publik; • Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh; • Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë; • Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore; • Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore; • Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes. |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Bashkia siguron përdorim të qendrueshëm të pyjeve dhe kullotave*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Përmirësimi i shërbimit pyjor dhe kullor ne HA*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Shtimi i sipërfaqes se pyllezuar*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Shtimi I sipërfaqes se pyllezuar HA*

Produkti

- *Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullor*

- *Inspektim dhe kontroll i sipërfaqes pyjore/kullosore*
- *Siperfaqe pyjore e rehabilituar*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e monitorimit dhe mbrojtjes së tokës dhe pyjeve.*
- *Aktivitetet e inspektimit të të gjitha hapësirave kullosore dhe pyjore për prerje të paligjshme të lëndës drusore duke marrë parasysh hapësirat e shfrytëzuara dhe ato të pashfrytëzueshme*
- *Ripyllëzimi i sipërfaqeve të djegura dhe sipërfaqeve të përdorura duke investuar në pyje me standartin 1667 fidanë/ha sipas skemës 3m x 2m; sistemime malore me gabiona dhe mure guri; etj.*

Vlera për realizimin e këtij funksioni është 3,468,297 lekë ,nga të cilat përballohen shpenzimet për personelin në vlerën 3,446,797 lekë , shpenzime operative në vlerën 21,500 lekë. Ky program mbulohet në vlerën 1,167.000 lekë nga transfertat specifike dhe 2,301,297 lekë nga të ardhurat tona.

Shpenzimet korente dhe kapitale 2023 dhe plani për vitin 2024.

| | Plani 2023 | Plani 2024 |
|---------------------------|-------------------|-------------------|
| <i>Shpenzime Korente</i> | 3,845,809 | 3,468,297 |
| <i>Shpenzime Kapitale</i> | 0,000 | 0,000 |
| Totali | 3,845,849 | 3,468,297 |

Vështrim i përgjithshëm i Programit “Administrimi i Pyjeve”.

Synimi kryesor i këtij funksioni është përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave.

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet bashkia siguron përdorim të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Përmirësimi i shërbimit pyjor dhe kullosor. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për pyjet dhe kullotat.

1-Kontrolle

Kontrolle të vazhdueshme në ekonomitë pyjore “Drenie” dhe “Lumi Seman 2” mbi dëmet e shkaktuara në pyje si dëme nga zjarret, prerjet dhe zëniet e fondit pyjor. Nga kontrollet e ushtruara nuk janë konstatuar dëme në pyjet të cilat administrohen nga Bashkia Patos. Problemi më shqetësues është ndërhyrja në fondin pyjor, duke i zaptuar dhe tjetërsuar në vite me mbjelljen e drurëve frutore.

2-Masa për mbrojtjen e pyjeve.

Janë përpiluar dhe prodhuar tabela me siglën “Mbroni Pyjet”, “Pyjet janë burimi i jetës”, “Mos ndiz zjarrë në pyll”, “Mos hidh cigare në pyll” etj., të cilat janë të hartuara nga ana jonë dhe janë të shpërndara në të gjitha rrugët të cilat përshkojnë fondin pyjor të Bashkisë Patos.

Janë përpiluar gjithashtu edhe tabela orientuese dhe sinjalizuese për monumentet e natyrës të cilat janë vendosur në të gjitha monumentet që ndodhen në territorin e Bashkisë Patos, si Rrepet e Peshkëpive, Rrapi i Zhugrit dhe Kanionet e Siqecës.

3-Inventari i pyjeve dhe përpilimi i hartave pyjore.

Gjatë vitit 2023 janë kontrolluar dhe inventarizuar të gjitha parcelat pyjore gjithashtu janë ballafaquar hartat pyjore të transferuara nga ish Drejtoritë e Shërbimit Pyjor me hartën kadastrale të ardhur nga Ministria e Mjedisit dhe ndryshimet janë dërguar për miratim Ministrisë së Turizmit e Mjedisit.

4-Mbrojtja nga zjarri.

Pë rmbrojtjen nga zjarri është hartuar plani i masave si Bashki, shtabi i mbrojtjes nga zjarri si dhe shtabet për Njësitë Administrative. Janë ngritur skuadrat zjarrfikëse dhe për secilin fshat është kryer instruktimi i tyre si dhe njohja dhe përcaktimi i rrugëve dhe metodave për fikjen e zjarreve si dhe parandalimin e tyre. Është rritur bashkëpunimi dhe me punonjësit e policies së rendit. Janë dërguar programet e punës për mbrojtjen nga zjarri pranë shtabit të rrethit dhe Ministrisë së Rendit.

- Shpenzime për investime nuk janë planifikuar për vitin 2024.

VI. RRJETI RRUGOR RURAL(INFRASTRUKTURA) BASHKIA.

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|------------------------|---|
| Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 04520 | Rrjeti rrugor rural | <ul style="list-style-type: none"> Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjes vendore; Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore; Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore; |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane, rurale dhe infrastrukturës . Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Permiresimi I infrastruktures*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane, rurale dhe infrastrukturës . Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit*
- *Ndertimi i mureve mbajtes ne qytet dhe rrethina me qellim shmangien e rreshqitjeve masive te dherave duke qene se qyteti i Patosit shtrihet ne nje zone kodrinore dhe ndertimi i mureve mbajtes eshte domosdoshmeri.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Permiresimi i infrastruktures*

Produkti

- *Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural*
- *Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur*
- *Rrjet Rrugor Rural i rehabilituar*
- *Siperfaqe e rikualifikuar*
- *Ndertim i tregjeve*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Rrugëve Rurale*
- *Mirëmbajtje rutinë dhe periodike e Km infrastrukturës rrugore rurale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve dhe i procedurave të prokurimit për ndërhyrje në mirëmbajtjen e rrugëve; sigurimi i mjeteve dhe bazës materiale për pastrim kanali, mbushjes së gropave me cakull, beton ose asfalt; etj.*
- *Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe lidhja e rrugëve dytësore me ato kryesore dhe nacionale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve, procedurave të prokurimit dhe zbatimi i ndërhyrjeve në rehabilitimin e rrugëve përmes zëvendësimit të shtresave të asfaltit, shtrimi i shtresave shtesë, pajisja e infrastrukturës rrugore rurale me sinjalistikë horizontale dhe vertikale, etj.*
- *Siperfaqe e rikualifikuar*

Vlera për realizimin e këtij funksioni është 117,852,854 lekë ,nga të cilat përballohen shpenzimet për personelin në vlerën 16,667,801 lekë , shpenzime operative në vlerën 5,362,053 lekë dhe shpenzime për investime në vlerën 95,823,000 lekë. Ky program mbulon pjesën më të madhe të investimeve.

Shpenzimet korente dhe kapitale 2023 dhe plani për vitin 2024.

| | <i>Plani 2023</i> | <i>Plani 2024</i> |
|---------------------------|-------------------|--------------------|
| <i>Shpenzime Korrente</i> | 12,479,048 | 22,029,854 |
| <i>Shpenzime Kapitale</i> | 71,477,345 | 95,823,000 |
| <i>Total</i> | 83,956,393 | 117,852,854 |

➤ **Vështrim i përgjithshëm i Programit .**

Mirëmbajtja e rrugëve

Bashkia e Patos nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve dhe Agjensinë e Shërbimeve Publike, realizon:

- mirëmbajtjen e rrugëve qytetase,
- mirëmbajtjen e sistemit të ndriçimit rrugor të qytetit,
- mirembajtjen e shkollave,

Mirembajtja e rrugëve

Ky shërbim synon mirëmbajtjen e rrugëve parësore dhe dytësore, trotuareve, mirëmbajtjen e sinjalistikës rrugore, mirëmbajtje të shkollave, kopshteve e cerdhes, punime të tjera punime keto që kryehen dhe në bashkëpunim me Agjensinë e Shërbimeve Publike .

Ndriçimi i qytetit, Dekori

Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit rrugor të qytetit, nëpërmjet blerjes së bazës materiale për ndriçim, duke realizuar:

- Eliminimin e të gjitha dëmtimeve, vjedhjeve që kanë ndodhur në rrjetin e ndriçimit rrugor,
- Përmirësimin e ndriçimit në disa blloqe banimi në qytetin e Patosit,
- Uljen e shpenzimeve për energji elektrike,
- Vazhdimin e projektit për montimin e paneleve të kontrollit të fluksit të ndriçimit në rrugët e qytetit.
- Dekor ku do të përfshihen të gjitha shpenzimet për banderolat, festat e fundvitit që do të përdoren në qytet gjatë festave zyrtare.

Shpronësimet

- Shpronësime për objekte të reja: Në plan buxhetin afatmesëm janë parashikuar rikualifikime blloqesh në qytet, rikonstruksione rrugësh, të cilat kërkojnë shpronësime të objekteve të cilat prekin gjurmën e projektit.

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet operative:

| Nr | Shpenzime Operative | Viti 2024 | Raporti në % |
|-----------|-------------------------------------|------------------|--------------|
| 1a | Shpenzime të tjera operative | 5,362,053 | 100% |
| 1 | Dekor | 3,000,000 | 56% |
| 2 | Shpronësime: për projekte të reja | 2,362,053 | 44% |

➤ **Shpenzimet kapitale për vitin 2024:**

Ndërhyrjet dhe problematikat

| | |
|--|---|
| <p>1. Ndërtim mure mbajtëse në qytet dhe rrethina</p> | <p>Ky investim është parashikuar për ndërtimin e mureve mbajtës në disa nga zonat në qytet kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none">• Mur mbajtës në fshatin Dukas• Mur mbajtës në rrugën Demokracia• Mur mbajtës në rrugën Banaj <p>Objektivi i këtij investimi është sistemimi dhe sigurim i stabilitetit të dherave duke shmangur problematikën e rrëshqitjeve.</p> <p>Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët e zonave përkatëse</p> <p>Vlera e zbatimit të projektit: 11,000,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit.</p> |
| <p>2. Ndriçim rrugor</p> | <p>Ky projekt parashikon investime në shtim të ndriçimit në ato segmente që janë në errësirë. Për ndërtimin e rrjetit janë parashikuar vendosja llampave të teknologjisë LED dhe paneleve të komandimit me të reja. Në zonat rurale ku edhe furnizimi me energji elektrike është i vështirë dhe me kosto, është parashikuar të instalohen impiante autonome me panele fotovoltaike. Prioritet u është dhënë rrugëve të Njësive Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie si dhe disa segmenteve brenda unazës së qytetit të Patosit.</p> <p>Përfituesit nga ky projekt janë: Gjithë banorët e Bashkisë Patos.</p> <p>Vlera e zbatimit të projektit: 9,500,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit.</p> |
| <p>3. Sinjalistika rrugore</p> | <p>Investim me blerje bazë materiale dhe do të bëhet kompletimi me sinjalistikë horizontale dhe vertikale në segmentet rrugore brenda qytetit dhe tabela për emërtimin e rrugëve në Njësitë Administrative.</p> <p>Punimet do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike sipas udhëzimeve nga Sektori i Shërbimeve.</p> <p>Përfituesit nga ky projekt janë: Gjithë banorët e Bashkisë Patos.</p> <p>Vlera e zbatimit të projektit: 1,500,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit.</p> |

| | |
|--|---|
| <p>4. Ndërtim të trotuareve dhe shesheve të pallateve (Blerje Bazë Materiale)</p> | <p>Ky investim për blerje të bazës materiale do të përdoret për ndërhyrjet që do të bëhen kryesisht në rrugët e ndërtuara me asfaltobeton sipas marrëveshjes kuadër që është zbatuar për shtrimin e disa rrugëve të brendshme në Njësitë Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie si dhe në disa zona periferike të Bashkisë Patos.</p> <p>Projekti ka parashikuar ndërtimin e trotuareve përgjatë rrugës për ti shërbyer banorëve të zonës. Ndërtimi i trotuareve do të bëhet sipas strukturës dhe terrenit që krijon mundësinë për ndërtimin e tyre, pra trotuarët do të variojnë me gjerësi nga 1.5 – 2.5m. Realizimi i trotuareve do të bëhet me pllaka betoni dhe do të ketë prani të pemëve dekorative. Përgjatë gjatësisë së tyre do të mundësohet dhe ndriçim dhe në disa rrugë qendore do të realizohen trotuare në të dy krahet.</p> <p>Përfituesit nga ky projekt janë: Gjithë banorët e qytetit Patos dhe Njësi Administrative Vlera e zbatimit të projektit: 7,000,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit.</p> |
| <p>5. Rikonstruksioni i Rrugës në Lagjen e Re te përroi</p> | <p>Ky segment rrugor përfshin segmentin kryesor të lagjes në një gjatësi L= 700ml, b=4m dhe të gjitha degëzimet që dalin nga rruga kryesore. Aktualisht rruga është e pashtruar dhe ka nevojë për ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës së saj për lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe mjeteve që përdorin këtë segment rrugor.</p> <p>Është parashikuar ndërtimi i një ure me konstrukcion betonarme me gjerësi 4m. Ndërtimi i trotuarit është menduar vetëm në njërin krahë të rrugës më gjerësi b=1.2m. Linja e ujërave të zeza do të ndërtohet me tubo HDPE me diametër Ø200, Ø250, Ø315 dhe puseta b/a çdo 28m me përmasa 1*1*1.5m. Disiplinimi i ujërave të bardha do të ndërtohet me tubo HDPE Ø200 dhe derdhja e ujërave do të bëhet direkt në pusetat e ujërave të zeza.</p> <p>Punimet që përfshin projekti janë si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ndërhyrje në rehabilitimin e shtresave rrugore. -Sistemim i sipërfaqeve të terrenit në të dy anët e rrugës -Disiplinimi dhe sistemimi i ujërave të bardha dhe ujërave të zeza. - Ndërtim i trotuarit me gjerësi b=1.2m. - Hapësira të gjelbëruara - Ndriçim rrugor. <p>Përfituesit nga ky projekt janë:</p> |

BUXHETI 2024

| | |
|---|---|
| | <p>-Rreth 400 banorë të zonës Vlera totale e parashikuar për këtë projekt sëbashku me mbikqyrje dhe kolaudim: 35,965,000 leke me financim si mëposhtë: Në 2023: 16,800,000 lekë -Në 2024: 19,165,000 lekë Kohëzgjatja e Projektit: 2-Vite.</p> |
| <p>6. Blerje Bazë Materiale për Rikonstruksionin e Rrethimit të varrezave Publike dhe zgjerimin e rrugëve të Brendshme</p> | <p>Ky investim konsiston ne blerjen e bazes materiale per nderhyrjet qe do te kryhen per permiresimin e varrezave publike në territorin e bashkisë Patos dhe rrugeve te brendshme. Punimet konsistojne ne varesi te nevojave prioritare qe do te lindin. Punimet do te kryhen nga Agjencia e Sherbimeve Publike sipas udhezimeve nga Sektori i Sherbimeve Publike. Perfituesit nga ky projekt jane: - Banoret e gjithe qytetit Vlera e zbatimit të projektit: 5,000,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit.</p> |
| <p>7. Hartimi i PDV--VE të përcaktuara sipas PPV-së dhe studim projektim për projekte të ndryshme</p> | <p>Për t'iu përgjigjur nevojave aktuale të qytetit si dhe kërkesave në rritje për struktura shërbimi, Bashkia ka marrë nismën për zhvillimin e disa makro-zonave që do të mundësojnë rritjen e kapaciteteve të qendrave më të rëndësishme të territorit. Njësitë strukturore, pjesë e këtij studimi, janë të përcaktuara nga Plani i Përgjithshëm Vendor si zona për zhvillim intensiv. Në këto zona parashikohet zgjerimi i qytetit me lagje të reja banimi apo zona të shoqëruara me shërbimet e nevojshme si dhe me hapësirat publike. Përfituesit nga ky projekt janë: Banorët e zonave përkatëse si dhe të tjerë qytetarë që indirekt kanë akses apo marrin shërbim në këto zona. Vlera totale e parashikuar për këtë projekt sëbashku me mbikqyrje dhe kolaudim: Në vitin 2024: 1,000,000 lekë</p> |
| <p>8. Rikualifikimi Urban Blloku Qendër Para Pallatit të Kulturës</p> | <p>Rikualifikimi urban në bllokun para Pallatit të Kulturës në lagjen “1-Maj” është investim i planifikuar në vitin 2024. Në hartim të projektit do të parashikohet të riurbaziohet zona që fillon nga rruga “Mustafa Matohiti” deri në rrugën “Demokracia”. Pjesa tjetër e sipërfaqes është lulishte, gjelbërim , ambiente shlodhëse per femijë dhe të moshuar. Punimet që përfshin projekti janë si mëposhtë:</p> |

BUXHETI 2024

| | |
|--|--|
| | <p>-Ndërhyrje në kolektorin e KUZ dhe KUB të cilat do të ndërtohen të rinj.</p> <p>-Prishje të gardheve rrethues ekzistues të pa hipotekuara.</p> <p>-Realizimin e ndriçimit publik të rrugëve dhe brenda bllokut.</p> <p>-Ndërtimi i lulishteve, pikave pushimit për qytetarët si dhe gjelbërim përgjatë gjithë bllokut.</p> <p>Përfituesit nga ky projekt janë:</p> <p>- Banorët e zonës dhe bizneset që kanë aktivitet në këtë zonë.</p> <p>Vlera totale e parashikuar për këtë projekt sëbashku me mbikqyrje dhe kolaudim: 38,000,000 lekë me financim si mëposhtë:</p> <p>- Në vitin 2024: 17,000,000 lekë</p> <p>- Në vitin 2025: 21,000,000 lekë</p> <p>Kohezgjatja e Projektit: 2 vjet</p> |
| 9. Rikonstrukcion Rruga e Vreshtit | <p>Ky segment rrugor ndodhet në Lagjen e Re dhe ka një gjatësi rreth 1530 ml dhe gjerësi 4 m. Aktualisht rruga është e pashtruar dhe ka nevojë për ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës së saj për lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe mjeteve që përdorin këtë segment rrugor.</p> <p>Punimet që përfshin projekti janë si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Punime gjurmimi dhe mbushje• Punime shtresa rrugore• Punime të mureve mbajtëse• Punime trotuari në segmente të pjesshme• Ndriçim në pjesën e trotuarit• Punime për rrjetin KUZ dhe KUB <p>Përfituesit nga ky projekt janë:</p> <p>Banorët e Lagjes së Re- Vresht që përdorin këtë rrugë.</p> <p>Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 28,064,988 lekë me financim si mëposhtë:</p> <p>-Në vitin 2024: 12,000,000 lekë</p> <p>-Në vitin 2025: 16,064,988 lekë</p> <p>Brenda vlerës së projektit përfshihet edhe vlera e mbikqyrësit dhe kolaudatorit.</p> <p>Kohezgjatja e Projektit: 2-Vite</p> |
| 10.Rikonstrukcioni i Rrugës Gjinoqarë | <p>Ky segment rrugor ndodhet në fshatin Gjinoqarë në Njësinë Administrative Ruzhdie dhe ka një gjatësi rreth 850 ml dhe gjerësi 4 m dhe bankina 40cm. Aktualisht rruga është e pashtruar dhe ka nevojë për ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës së saj për lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe mjeteve që përdorin këtë segment rrugor. Ky është një segment lidhës midis fshatrave.</p> <p>Punimet që përfshin projekti janë si mëposhtë:</p> |

BUXHETI 2024

| | |
|--|---|
| | <p>-Zgjerimin e rrugës ekzistuese. -Shtrimi me asfaltobeton. -Punime shtresash - Ndërtimi i mureve mbajtës -Sistemime dherash. - Sistemimi i ujërave të shiut Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët e fshatit Gjinoqarë rreth 400 banorë Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 35,000,000 lekë me financim si mëposhtë: -Në vitin 2024: 6,500,000 lekë -Në vitin 2025: 18,500,000 lekë -Në vitin 2025: 10,000,000 lekë Brenda vlerës së projektit përfshihet edhe vlera e mbikqyrësit dhe kolaudatorit. Kohëzgjatja e Projektit: 3-Vjet</p> |
| 11. Ndërtimi i tregut të fruta perimeve lagjja 1 Maji | <p>Ky investim konsiston ne krijimin e nje tregu te perbashket per te gjithë tregtarët ne qytetin e Patosit duke sjelle nje lehtesim per grumbullimin dhe shitjen e produkteve bujqesore. Projekti eshte parashikuar te ndertohet me strukture metalike ne lagjen 1 Maj, i pershatshem dhe i lokalizuar qe te jetë e aksesueshme për të gjithë banorët e qytetit. Përfituesit nga ky projekt janë: - Banoret e qytetit të Patosit Vlera totale e parashikuar për këtë blerje: -Në vitin 2024: 4,058,000 lekë -Në vitin 2025: 6,500,000 lekë</p> |
| 1. Blerje pajisje GPS | <p>Ky investim është parashikuar për blerjen e pajisjes GPS për të kryer matje dhe rievime topografike të relievit të territorit të Bashkisë Patos. Është parashikuar blerja e GPS për kryerjen e matjeve në një kohë sa më të shpejtë dhe të ketë mundësi aksesimin në zonat në të cilat nuk mund të përdoret total station Vlera totale e parashikuar për këtë blerje: -Në vitin 2024: 2,100,000 lekë</p> |

VII. RRJETI RRUGOR RURAL ASHP.

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|------------------------|---|
| Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 04520 | Rrjeti rrugor rural | <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsitë biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië të njësisë së vetëqeverisjes vendore; • Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore; |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane, rurale dhe infrastrukturës ,mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Permiresimi I infrastruktures*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane, rurale dhe infrastrukturës ,mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Permiresimi i infrastruktures*

Produkti

- *Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural*
- *Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur*
- *Rrjet Rrugor Rural i rehabilituar*

Përshkrimi i Produkteve:

- Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Rrugëve Rurale
- Mirëmbajtje rutinë dhe periodike e infrastrukturës rrugore rurale.

Vlera për realizimin e këtij funksioni është 3,697,102 lekë ,nga të cilat përballohen shpenzimet për personelin në vlerën 3,552,500 lekë dhe shpenzime për investime në vlerën 144,602 lekë. Ky program mbulohet në vlerën 2,232.000 lekë nga transferata specifike dhe 1,465,102 lekë nga të ardhurat tona.

➤ **Shpenzime operative nuk janë planifikuar.**

| Shpenzimet | Plani 2023 | Plani 2024 |
|---------------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzime Korrente | 2,644,145 | 3,552,500 |
| Shpenzime Kapitale | 144,602 | 144,602 |
| Total | 2,788,747 | 3,697,102 |

Ky program në bazë udhëzimit të PBA-së 2024-2026 nga Ministria e Financave përfshin edhe të gjitha investimet në infrastrukturë dhë për këtë arsye ne e kemi ndarë këtë programi në 2 (dy) njësi shpenzuese , në njësinë shpenzuese Bashkia Patos dhe njësinë shpenzuese Agjensia e Shërbimeve Publike ku kemi vendosur kryesisht shpenzimet që janë nga transferata specifike për këtë program. Synimi kryesorë ne drejtim te sistemit rrugore urban dhe atij rural te Bashkise se Patosit do te jete : permiresimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses te plot te tyre ne sistemimin e infrastrukturës rrugore kombetare Tashme rrjeti rrugore urban i qytetit lidhet me rrjetin kombetar rrugore nepermjete unazes kryesore dhe unazës rurale tëqytetit.

Shpenzimet kapitale për vitin 2024:

Ndërhyrjet dhe problematikat

| | |
|---|--|
| I. Nderhyrje rruge RURALE (Baza materiale) | Projekti konsiston përmirësimin e rrjetit rrugor rural . Vlera e zbatimit të projektit: 144,602 leke Kohëzgjatja e projektit Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit. |
|---|--|

VIII. MENAXHIMI I MBETJEVE , ASHP.

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|--|------------------------|--|
| Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 05100 | Menaxhimi i mbetjeve | <ul style="list-style-type: none"> • Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; • Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; • Pastrimi i rrugëve, parqeve etj. |
| | | |
| | | |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Përmirësimi i shërbimeve të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve*

Treguesit e Performancës për Objektivin

Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Produkti

- *Shërbimi i stafit të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit*

- *Pastrimi i rrugëve dhe parqeve*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Pastrimit të qytetit, NJA; mbledhjen, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve.*
- *Sipërfaqja e rrugëve urbane që fshihet/lahet çdo ditë gjatë gjithë vitit, shpenzimet për kriposjen e rrugëve apo pastrimin e tyre nga dëbora gjatë muajve të dimrit.*

Vlera për realizimin e këtij funksioni është 52,778,140 lekë ,nga të cilat përballohen shpenzimet për personelin në vlerën 29,982,366 lekë , shpenzime operative në vlerën 16,139,774 lekë dhe shpenzime për investime në vlerën 6,656,000 lekë.

Shpenzimet korente dhe kapitale 2023 dhe plani për vitin 2024.

| | <i>Plani 2023</i> | <i>Plani 2024</i> |
|---------------------------|-------------------|-------------------|
| <i>Shpenzime Korrente</i> | 38,659,653 | 46,122,140 |
| <i>Shpenzime Kapitale</i> | 2,507,834 | 6,656,000 |
| <i>TOTALI</i> | 41,167,487 | 52,778,140 |

Vështrim i përgjithshëm i Programit.

Këto fonde do të shkojnë në realizimin e Qëllimit dhe Objektivave të Politikave të Programit me moton “Për një qytet të paster” duke venë në efikasitet plot Asetet e burimeve njerëzore, mjetet e transportit dhe burimet financiare për ofrimin e shërbimeve me cilësi sipas standarteve bashkëkohore, në mbledhjen e mbetjeve urbane, organike nga kontineret dhe pikat fikse duke siguruar një ambient të paster dhe pa ndotje, në shtrirjen e shërbimeve publike me mbledhjen e mbetjeve urbane në zonat periferike dhe informale, në mbajtjen paster të rrugëve kryesore, dytesore të 108.000 m² rrugë, shesheve të pallateve, kopshtet, çerdhet dhe institucionet e tjera.

➤ **Shpenzimet operative të programit për vitin 2024:**

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet operative për shërbimin publik (pastrim, menaxhim mbetjesh):

BUXHETI 2024

| Nr | Shpenzime Operative | Viti 2024 | Raporti në % |
|----|-------------------------------|-------------------|--------------|
| 1 | Total | 16,139,774 | 100% |
| 1a | Materiale e shërbime speciale | 600,000 | 4% |
| 1b | Shërbime nga të tretë | 140,000 | 1% |
| 1c | Shpenzime transporti | 10,390,000 | 64% |
| 1d | Mirembajtje te zakonshme | 620,000 | 4% |
| 1e | Shpenzime te tjera operative | 4,389,774 | 27% |

➤ **Shpenzimet kapitale për vitin 2024:**

Ndërhyrjet dhe problematikat

| | |
|------------------------------------|---|
| 1. Konteniere per 3 njesite | Blerje kontenieresh per 3 njesite . Vlera e zbatimit të projektit: 3,506,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit. |
| 2. Kosha plastik riciklues | Blerje kosha plastik riciklues. Vlera e zbatimit të projektit: 3,000,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit. |
| 3. Pajisje per lavazho | Blerje pajisje për lavazho ku do të bëhet larja dhe pastrimi i të gjithë mjeteve dhe pajisjeve të Bashkisë Patos. Vlera e zbatimit të projektit: 150,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit |

IX. MENAXHIMI I MBETJEVE , MBROJTJA E MJEDISIT BASHKIA PATOS

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|--|------------------------|--|
| Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 05100 | Menaxhimi i mbetjeve | <ul style="list-style-type: none"> • Masa mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja; • Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes, si dhe masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes; • Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin e ndotjes; • Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit. |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Administrimi, kordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve për promovimin e mbrojtjes mjedisore; • Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor. • Identifikim, kontroll dhe menaxhim i burimeve ujore brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Përmirësimi i shërbimeve të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve*

Objektivi i Politikës së Programit

- Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Treguesit e Performancës për Objektivin

Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Produkti

- Subjekte të inspektuara
- Realizimi i aktiviteteve të ndryshme për sensibilizimin apo impakt të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit.

Përshkrimi i Produkteve:

- Ky produkt përfshin aktivitetet dhe kostot që lidhen me inspektimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të subjekteve apo aktiviteteve me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Këtu do të përfshihen si shpenzimet e personelit, ashtu edhe ato të operimit të shërbimit.
- Realizimi i aktiviteteve të ndryshme për sensibilizimin apo impakt të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit.

Vlera për realizimin e këtij funksioni është **1,378,121** lekë ,nga të cilat përballohen shpenzimet për personelin në vlerën **1,378,121** lekë dhe shpenzime operative në vlerën **463,466** lekë.

Shpenzimet korente dhe kapitale 2023 dhe plani për vitin 2024.

| Shpenzimet | Plani 2023 | Plani 2024 |
|---------------------------|-------------------|-------------------|
| <i>Shpenzime Korrente</i> | 1,218,796 | 1,378,121 |
| <i>Shpenzime Kapitale</i> | 0 | 0 |
| Total | 1,218,796 | 1,378,121 |

Vështrim i përgjithshëm i Programit.

Për menaxhimin sipas ligjit, të mbetjeve të prodhuara nga familjet Bashkia Patos do të realizojë projekte me në fokus ndërgjegjësimin e banorëve për ndarjen e mbetjeve në burim. Do të realizohen projekte në lagje pilot të Bashkisë Patos dhe në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

Qëllimi: Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të mbetjeve, reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.

Rezultate:

- Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve duke përdorur teknologji bashkëkohore.
- Ofrimi i shërbimit cilësor, në kohë dhe në të gjithë territorin.
- Reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.
- Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim.

1. MENAXHIMI I MBETJEVE

Bashkia Patos synon një mjedis të pastër me cilësi të lartë në vazhdimësi, falë punës dhe kontributit të përbashkët të komunitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke synuar ndarjen në burim në të gjithë territorin, për një jetesë të shëndetshme. Në mbështetje të ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”, Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit në Bashkinë Patos synon progresin gradual drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Menaxhimi në nivel lokal përfshin zbatimin e skemave të minimizimit të mbetjeve në qytetin e Patosit dhe në shkollat e qytetit për të reduktuar në mënyrë progresive mbetjet për në incinerator. Lidhur me burimet e gjenerimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake ndahen në dy rryma mbetjesh, sipas burimit të origjinës:

1.MF mbetjet e prodhuara nga familjet

2.MB mbetjet e prodhuara nga bizneset dhe industritë

Për menaxhimin sipas ligjit, të mbetjeve të prodhuara nga familjet Bashkia Patos do të realizojë projekte me në fokus ndërgjegjësimin e banorëve për ndarjen e mbetjeve në burim. Do të realizohen projekte në lagje pilot të Bashkisë Patos dhe në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

Qëllimi: Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të mbetjeve, reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.

Rezultate:

- Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve duke përdorur teknologji bashkëkohore.
- Ofrimi i shërbimit cilësor, në kohë dhe në të gjithë territorin.
- Reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.

- Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim.
- Kontribut në Planin e Zhvillimit Vendor lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

➤ **Shpenzimet operative të programit për vitin 2024:**

| Nr | Shpenzime Operative | Viti 2024 | Raporti në % |
|-----------|---|----------------|--------------|
| 1a | Shpenzime të tjera operative | 463,466 | 100% |
| 1 | Monitorim i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz. | 170,000 | 37% |
| 2 | Shërbimi DDD | 200,000 | 43% |
| 3 | "Arti i Gjëlber" | 13,466 | 3% |
| 4 | Konsulencë mjedisore(Për leje mjedisi tipi B) | 80,000 | 17% |

1. Monitorim i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz

-Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 26 Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit”, Ligjit Nr 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, Ligjit Nr.10 431 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 26 Normat e cilësisë së mjedisit, si edhe Ligjit nr.10 433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Patos do të kryej shërbimin për monitorimin e mjedisit në zonat e ndotura në territorin e Bashkisë Patos kryesisht në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz. Ky monitorim bëhet për të mësuar nivelin e ndotjes dhe për të propozuar masat që duhet të merren për të shmangur ndotjen. Kërkohej që ky monitorim të kryhet nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që disponon operatori. Operatori duhet të jetë i pajisur me certifikatën e laboratorit të specializuar e të akredituar nga Ministria e Mjedisit sipas legjislacionit në fuqi. Ky shërbim shkon rreth **170,000 lekë**.

2. Mbrojtja e Shëndetit, Shërbimi DDD.

-Në mbështetje të vendimit Nr.369, datë 26.07.1993 “Për Riorganizimin e Shërbimit, të Dezinfektimit,Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD), ku thuhet se ky shërbim kalon në vartësi të organeve të pushtetit vendor, si edhe nisur nga detyrat e lëna nga Inspektoriati Shtetëror i Shëndetit për pajisje me Certifikatën e shërbimit (DDD) të institucioneve si shkollat,kopshte dhe çerdhe.

- Shërbimi (DDD) duhet kryer nga persona të trajnuar.): Pajisjet dhe materialet të cilat pëdoren për DDD, duhet të jenë të cilësisë së lartë dhe të certifikuara .

Shërbimi do të kryhet ne : Shkolla, kopshte dhe çerdhe. Pas kryerjes së shërbimeve DDD bëhet pajisja me certifikat – dëshmi mbi kryerjen e shërbimeve të caktuara.

Dezinfektimi – bëhet me qëllim të shkatërrimit të mikroorganizmave patogjen, parandalimin e sëmundjeve infektive në ambientet ku punohet.

Dezinfektimi bëhet me preparate përkatëse për shkatërrimin e bakterieve gram positive dhe bakterieve gram negative, sporeve, myqeve dhe viruseve.

Dezinsektimi – bëhet me qëllim të mbytjes, largimit dhe pengimin e shumëzimit të Insekteve.

Dezinsektimi bëhet me preparate përkatëse që ndikojnë në luftimin e insekteve si :Preparate që shkaktojnë mbytjen e insekteve (insekticide) dhe Preparate që shkaktojnë largimin e insekteve nga hapësira të ndryshme.

Deratizimi – bëhet me qëllim të largimit të minjëve, me qëllim të parandalimit të dëmtimeve që sjellin minjtë(brejtësit).

Deratizimi bëhet me preparate përkatëse “Rodenticide”. Egzistojnë mjete fizike speciale për vendosjen e rodenticideve, këto mjete janë ekologjike dhe të siguruara nga prekja fizike e fëmijëve.

Shërbimi DDD për gjithë ambientet e institucioneve si: shkolla, kopshte dhe çerdhe të ndodhura në territorin e Bashkisë Patos shkon rreth: **200.000 lekë**

3.Projekte Mjedisore

a) “ARTI I GJELBËR”

Përshkrimi i projektit:

Ky projekt do t’i jap mundësinë të rinjve të shpalosin aftësinë e tyre, talentin dhe imagjinatën e tyre duke sjellë me anë të vizatimeve mesazhe mjedisore që na kujtojnë se mjedisi është shtëpia jonë e përbashkët.

Qëllimi:

Përcjellja e mesazheve për mbajtjen pastër të mjedisit, mbrojtjen e natyrës, ruajtjen e burimeve natyrore, riciklimin etj.

Rezultate:

-Ndërgjegjësim i nxënësve lidhur me mjedisin.

-Zhvillimi i kreativitetit.

-Mbrojtja e mjedisit.

Për realizimin me sukses të këtij projekti na nevojitet një fond prej **13,466 lekësh** i cili do të shërbejë për blerjen e materialeve të tilla si bojra, penela dhe materiale të tjera që do t'u shpërndahen shkollave për të zhvilluar aktivitetin.

B)“PARKU ME MATERIALE TË RICIKLUESHME”

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Përfshirja e shumë aktorëve në këtë iniciativë rinore, krijon një ndërgjegjësim mbi mjedisin:

- Të rinjtë e shkollave do të krijojnë dhe zbatojnë idetë e tyre inovative, duke marrë pronësinë e suksesit të këtij projekti dhe eksperiencën për ta replikuar në mjedise të tjera.
- Të rinjtë vullnetarë do të ndihmojnë në punimin me materialet e riciklueshme. Forcimi i partneritetit midis aktorëve, do të çojë në promovimin e iniciativave të përbashkëta të zhvillimit lokal dhe rajonal, përmirësimin e mjedisit dhe shërbimeve në zonë.

Qëllimi:

Tu ofrojë të rinjve një zonë të sigurt të gjelbër që mbështetet në inovacionin dhe kreativitetin e tyre.

Rezultate:

Të rinjtë e shkollave të mesme dhe 9- Vjeçare, rrisin informacionin, interesin dhe ndërgjegjesimin mbi çështjet mjedisore dhe ato të pjesëmarrjes qytetare në projekte komunitare. -Vlerësimi i iniciativave dhe ideve inovative të të rinjve në zbatimin e projektit dhe bashkëpunimi i tyre me NJQV.

Krijimi i një modeli të përfshirjes së të rinjve, i promovuar online.

4.Konsulencë Mjedisore

Në mbështetje të ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 PËR LEJET E MJEDISIT, ligjit 10 431 “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”, për venddepozitimin e mbetjeve inerte na nevojitet pajisje me leje mjedisi kjo konsulencë do të shërbejë për hapat që do të ndiqen për pajisje me leje mjedisi të venddepozitimit. Për pajisje me leje mjedisi na nevojitet fondi prej **80,000 lekësh**.

- Shpenzime për investime nuk janë planifikuar për vitin 2024.

X. SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE , ASHP

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|--|---------------------------|--|
| Sigurimi i ofrimit të shërbimeve publike vendore | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 06260 | Shërbimet publike vendore | <ul style="list-style-type: none"> • Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; • Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore; • Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve; • Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; • Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike; • Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore; |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike; • Zhvillimi, rregullimi dhe përmirësimi i standardeve të ndriçimit rrugor. |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Përmirësimi i hapësirave publike dhe sistemit të ndriçimit, Shërbim cilësor me standarte dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberuara, parqeve, gjelberim rrugor, trotuare . Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Rritja e shërbimeve sipas standarteve bashkekohore për komunitetin*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Përmirësimi i hapësirave publike*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Përmirësimi i hapësirave publike në 3 njesite e bashkise*

Produkti

- *Shërbimi i stafit të ndërmarrjeve publike*
- *Mirëmbajtja e sipërfaqes së varrezave*
- *Rruge urbane e mirëmbajtur dhe rehabilituar*
- *Sipërfaqe e gjelbër e mirëmbajtur dhe rehabilituar*
- *Trotuare të mirëmbajtur dhe rehabilituar*
- *Objekte publike të mirëmbajtura*
- *Rrjeti i ndricimit rrugor publik urban i mirëmbajtur*
- *Rrjeti i ndricimit rrugor publik rural i mirëmbajtur*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve shoqërore për sektorët e mirëmbajtjes, gjelbërimit, menaxhimit të varrezave, dekorit të qytetit.*
- *Sipërfaqe ekzistuese e varrezave të qytetit të mirëmbajtura. Mirëmbajtja dhe sistemimi i parcelave të varrezave, rrugëve dhe trotuarëve ndarës; prokurimi i fidanëve; sistemimi i zonave të gjelberta; etj.*
- *Rruge urbane e mirëmbajtur në qytetet e NJVQV duke bërë kontrolle dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, rregullimin e sinjalistikës; etj.*
- *Mbjellje, shërbim, dhe mirëmbajtja e pemëve dekorative dhe shkurre me gjelbërim të përhershëm, shërbim bari i kultivuar, natyral, tapet bari, uje, punim rrënjësh, pleherim, spërkatje me pesticide. Kryerja e kontrolleve të rregullta të mirëmbajtjes për dy makineri (2 prerëse bari).*
- *Sipërfaqe trotuaresh e mirëmbajtur në qytetet e NJVQV duke bërë kontrolle dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, zëvendësimi i pllakave dhe bordurave, rregullimin e sinjalistikës; rregullimin e stolave; etj.*

- *Mirëmbajtja rutinë dhe periodike e objekteve të ndryshme administrative në pronësi të bashkisë, si psh. lapidare, shatërvane, etj.*
 - *Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat qytet të NJVQV; blerja e furnizimit me energji; prokurimi ndriçimit LED për zëvendësimin e llambave me ndricim të ngrohtë,shtyllave të ndriçimit km kablllo elektrik; etj.*
 - *Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat rurale të NJVQV; blerja e furnizimit me energji; prokurimi i llambave të ndriçimit, shtyllave të ndriçimit, km kablllo elektrik; etj.*
- *Vlera për realizimin e këtij funksioni është 130,344,629 lekë ,nga të cilat përballohen shpenzimet për personelin në vlerën 65,743,184 lekë , shpenzime operative në vlerën 32,160,445 lekë dhe shpenzime për investime në vlerën 32,441,000 lekë.*

Shpenzimet korente dhe kapitale 2023 dhe plani për vitin 2024.

| <i>Programi i Sherbimet Publike Vendore</i> | <i>Plani 2023</i> | <i>Plani 2024</i> |
|---|--------------------|--------------------|
| <i>Shpenzime Korrente</i> | 80,544,721 | 97,903,629 |
| <i>Shpenzime Kapitale</i> | 42,773,151 | 32,441,000 |
| Total | 123,317,872 | 130,344,629 |

➤ ***Vështrim i përgjithshëm i Programit.***

Këto fonde do të shkojnë në realizimin e Qëllimit dhe objektivave të Politikave të Programit në ofrimin e shërbimeve, përmiresimit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore sipas standarteve në të gjitha komponentet e saja të shtrire në qytet dhe në periferi për t'u mundësuar qytetarve shërbim në kohë, që t'u ofrojmë shërbime në mirëmbajtjen dhe përmirësim e rrugëve, trotuareve, mirëmbajtje e objekteve arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe), riparime, lysterje, merementime të ambienteve jashtë dhe brenda institucioneve, mirëmbajtje e rrjetit hidraulik si dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit rrugor dhe dekorit te qytetit .Gjithashtu në këtë program u garantohet komunitetit, një mjedis të gjelbërt në mirembajtjen e 12600 m2 sip gjelberuara, shërbim dhe mbajtje të 2397 drurë decorative, shtimin e sip të gjelberuara në ambjentet publike,social kulturore dhe sportive. Ky program synon dhe në mirëmbajtjen e 40 parcelave të varrezave publike e tre njesite administrative si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit,gjithashtu dhe në mirëmbajtjen dhe shtimin e zonave të reja me ndriçim rrugor.

➤ **Shpenzimet operative të programit për vitin 2024:**

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet operative :

| Nr | Shpenzime Operative | Viti 2024 | Raporti në % |
|-----------|---|-------------------|--------------|
| 1 | Total | 32,160,445 | 100% |
| 1a | Materiale zyre dhe të përgjithshme | 167,218 | 1% |
| 1b | Materiale dhe shërbime speciale | 350,000 | 1% |
| 1c | Shërbime nga të tretë | 14,630,000 | 45% |
| 1d | Shpenzime transporti | 9,515,000 | 30% |
| 1e | Mirëmbajtje të zakonshme | 6,983,227 | 22% |
| 1f | Shpenzime të tjera operative | 515,000 | 2% |

➤ **Shpenzimet kapitale për vitin 2024:**

Ndërhyrjet dhe problematikat

| | |
|--|---|
| <p><i>1. Blerje baze materiale për shtrim rrugësh të brendshme me Asfalto-Beton</i></p> | <p>Ky investim konsiston në blerje baze materiale, transporti i materialeve si çakell, stabilizant dhe asfaltobeton për shtrimin e rrugëve. Punimet do të kryhen në bashkëpunim me Agjencinë e Shërbimeve Publike. Objektivi kryesor është përmirësimi i kushteve të infrastruktures për banorët dhe urbanizimin e qytetit dhe Njësive Administrative.</p> <p>Rruget që do të shtrohen ndodhen në Njësine Administrative zharrez, ruzhdie dhe në brendësi të qytetit të Patosit.</p> <p>Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 2024-2026 është 93,982,000 leke me financim si mëposhtë:</p> <p>-Ne vitin 2024: 30,000,000 leke -Ne vitin 2025: 31,991,000 leke -Ne vitin 2026: 31,991,000 leke</p> <p>Kohezgjatja e Projektit: 3 vjet</p> |
|--|---|

BUXHETI 2024

| | |
|--|---|
| 2. Blerje Peme dekorative | Blerje peme dekorative per 3 njesite . Vlera e zbatimit të projektit: 1,091,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit. |
| 3. Korrese Bari Profesionale | Blerje korrese bari profesionale . Vlera e zbatimit të projektit: 400,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit. |
| 4. Blerje Pajisje Pune | Blerje pajisje pune . Vlera e zbatimit të projektit: 200,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit. |
| 5. Blerje Pajisje Pune ne sek MUR | Blerje pajisje pune . Vlera e zbatimit të projektit: 150,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit. |
| 6. Remont mjetesh | Remont mjetesh . Vlera e zbatimit të projektit: 600,000 leke Kohëzgjatja e projektit: Brenda vitit 2024 Financimi me buxhetin e vitit. |

XI. FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|--|---------------------------------|---|
| Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Funksionimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza. Ndërtimi dhe menaxhimi i sistemit të kolektorëve, kanaleve, tubacioneve dhe pompave për të larguar të gjitha ujërat e zeza (ujin e shiut, ujërat shtëpiakë dhe ujëra të tjerë të ndotur). | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i aktiviteteve të programit |
| 06370 | Furnizimi me ujë dhe Kanalizime | <ul style="list-style-type: none"> • Administrim i problemeve të furnizimit me ujë; • Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë; • Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë; • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë. |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza. |

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Funksionimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza.*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Permiresim Rrjeti KUZ dhe KUB*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Funksionimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Permiresim Rrjeti KUZ dhe KUB me fondet e bashkise*

Produkti

- *Zgjerim rrjeti KUZ dhe KUB*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Zgjerim rrjeti KUZ dhe KUB ne ml*

- Vlera për realizimin e këtij funksioni është 400,000 lekë ,nga të cilat përballohen për investime në vlerën 400,000 lekë.

Shpenzimet korente dhe kapitale 2023 dhe plani për vitin 2024.

| Shpenzimet | Plani 2023 | Plani 2024 |
|---------------------------|-------------------|-------------------|
| <i>Shpenzime Korrente</i> | 0 | 0 |
| <i>Shpenzime Kapitale</i> | 454,000 | 400,000 |
| Total | 454,000 | 400,000 |

- **Shpenzimet e personelit dhe shpenzimet operative për vitin 2024** janë parashikuar tek programi “Rruge Rurale” Infrastruktura Bashkia që është në të njëjtën drejtori ku është ky program .
- **Shpenzimet kapitale për vitin 2024:**

Ndërhyrjet dhe problematikat

| | |
|--------------------------------------|--|
| 1. Zgjerim rrjeti KUZ (tubo)” | <p>Ky investim do të kryhet vetëm me blerje bazë materiale të tubave me diametër përkatës sipas nevojave prioritare që do të lindin në rrugë apo terren në mënyrë që të eliminojmë problematikat lidhur me rrjetin e ujërave të zeza. Punimet do të kryhen nga Agjensia e Shërbimeve Publike sipas udhëzimeve nga Sektori i Shërbimeve Publike</p> <p>Përfituesit nga ky projekt janë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Banorët e gjithë qytetit <p>Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 400,000 lekë me financim si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none">-Në vitin 2024: 400,000 lekë |
|--------------------------------------|--|

XII. SPORT DHE ARGËTIM

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|--|------------------------|---|
| Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. | | |
| Kodi i programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
